



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

V E N D I M

Nr 3 Datë 04/03/2016

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT

“MENAXHIMI I BURIMEVE NATYRORE TË QARKUT VLORË”

Këshilli i Qarkut Vlorë , në mbledhjen e datës 04/03/2016 , në mbeshtetje të nenit 110, pika 2 e Kushtetutës , ku thuhet: "*Qarku është njësia ku ndërtohen e zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore*", ligjit Nr. 139/2015, date 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 31 Funksionet e Qarkut, pika 1, ku thuhet: "*Funksionet e veta të qarkut janë ndërtimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i vet i dhënë me ligj.*", si dhe në “Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut Vlorë 2011-2020” të miratuar me Vendim nr. 1, datë 25/03/2005 të K.Q Vlorë, pasi mori në konsideratë propozimin e bërë nga Kryetari i Këshillit të Qarkut për miratimin e programit “MENAXHIMI I BURIMEVE NATYRORE TË QARKUT VLORË”

V E N D O S I

1) Miratimin e programit “MENAXHIMI I BURIMEVE NATYRORE TË QARKUT VLORË”

- a. Dokumenti t'i shpërndahet gjithë njërive vendore të qarkut, si dhe gjithë të interesuarve, partnerëve lokal, ndërkombëtar dhe donatorëve.
- b. Dokumenti të përkthehet në të paktën një gjuhë të huaj (angleze)
- c. Të merren masa që dokumenti të promovohet tek të gjithë partnerët dhe donatorët

- 2) Për pasurimin e kësaj pakete me projekte të reja si dhe për përmirësimin e projekteve ekzistuese, duke pasur parasysh që ky është një program i gjerë, i larmishëm dhe i hapur, ku nevojiten studime dhe ekspertizë profesionale, institucioni mund të